



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

VENDIM

K.P.P. 108/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 27.02.2019, shqyrtoi ankesat me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të KVO-së lidhur me kualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “Albaelettrica” sh.p.k., & ”3A-Profile” sh.p.k, në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me objekt “*Rehabilitimi elektro-mekanik i vinçit urë 250/30/5 Ton në sallën e makinerisë në HEC Vau i Dejës*”, me nr. REF-97666-12-11-2018, me fond limit 89,000,000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 07.01.2019, nga autoriteti kontraktor KESH sh.a.

Shfuqizimin e vendimit të KSHA-së lidhur me skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Europa” sh.p.k., në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues: Operatori ekonomik “Europa” sh.p.k.
Adresa: Ish-Kombinati Metalurgjik, Bradashesh, Elbasan.

Autoriteti Kontraktor: KESH sh.a.
Adresa: Rr. ”Viktor Eftimiu”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë.

Subjekt i Interesuar: BOE “Albaelettrica” sh.p.k., & ”3A-Profile” sh.p.k
Adresa: Autostrada Tiranë – Durrës, Km.8, Kashar, Tiranë

Baza Ligjore: *Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet dhe pretendimet me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti kontraktor dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, të dokumentacionit të dërguar nga operatori ekonomik ankimues dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik ankimues ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ankimesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 12.12.2018 në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me objekt “Rehabilitimi elektro-mekanik i vinçit urë 250/30/5 Ton në sallën e makinerisë në HEC Vau i Dejës”, me nr. REF-97666-12-11-2018, me fond limit 89,000,000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 07.01.2019, nga autoriteti kontraktor KESH sh.a.

II.2 Në datën 07.01.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.3. Në datën 10.01.2019, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, ku rezultoi si më poshtë vijon:

1. "Albaelettrica" & "3A-Profile" shpk	69,934,000 lekë	Kualifikuar;
2. "Voith Hydro" GmbH & Co.KG (VPHO)	77,777,777 lekë	Skualifikuar;
3. "Cec Crane Engineering and Consulting" GmbH	81,672,925 lekë	Skualifikuar;
4. "Europa" shpk	87,100,000 lekë	Kualifikuar;

II.4.Në datën 15.01.2019 operatori ekonomik ankimues "Europa" sh.p.k ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së lidhur me kualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE "Albaelettrica" sh.p.k., & "3A-Profile" sh.p.k.

II.5. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 348/2 Prot. datë 22.01.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues "Europa" sh.p.k., duke mos pranuar ankesën lidhur me pretendimet e ngritura mbi ofertën e paraqitur nga BOE "Albaelettrica" sh.p.k., & "3A-Profile" sh.p.k, si dhe informon ankimuesin mbi vendimin e KSHA për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentimin si më poshtë vijon:

"[...] BASHKIMI I OPERATORËVE EKONOMIK "ALBA ELETTRICA & 3A -PROFILE" SH.P.K, për plotësimin e këtij kriteri ka paraqitur kontratë me Nr.2996/8, datë 07.09.2017 me objekt: "Furnizim dhe montimin e sistemit të mbledhjes, ndarjes së vajit nga uji dhe drenazhimet të ujit te Transformatorët dhe Hidroturbinat në HEC Fierzë dhe HEC Vau Dejës", me vlerë 173,812,835 Lek, Formularë Vlerësimi me Nr.106 Prot., datë 04.01.2019, në të cilin shprehet se kontrata është realizuar me sukses si dhe faturat tatimore të lëshuara për këtë kontratë. Gjithashtu si Operatori Ekonomik "ALBA ELETTRICA" sh.p.k dhe Operatori Ekonomik "3-A PROFILE" sh.p.k., kanë paraqitur edhe fatura me operatorë të ndryshëm lidhur me mallrat dhe shërbimet që do të furnizohen për këtë kontratë. Tenderi që zhvillohet është procedurë Shërbimi. Në VKM. 914 datë 29.12.2014, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, në Nenit 28, Kontrata e Shërbimeve, pika 3 kërkohej: "Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe faturave tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara". Referuar sa më sipër shërbimet e ngjashme në procedurën e kontratave të shërbimeve janë shumatore e vlerave deri në 40 % të vlerës së fondit që prokurohet, të cilat shoqërohen me faturë dhe vërtetim realizimi për kontratat me entet publike dhe faturë tatimore me entet private. Në kushtet kur BASHKIMI I OPERATORËVE EKONOMIK "ALBA ELETTRICA & 3-A PROFILE" SH.P.K, për eksperiencë të ngjashme kanë paraqitur kontratë të lidhur me Autoritetin Kontraktor KESH sh.a, të shoqëruar me vërtetim realizimi dhe faturat tatimore, vlerë e cila është në përputhje të plotë me kriteret për kualifikim të kërkuar në dokumentat e tenderit, dhe si e tillë plotësohet kriteri i kërkuar. Gjithashtu nga ky ofertues janë paraqitur edhe fatura për shërbime dhe mallra të njëjta ose të ngjashme me këtë tender që zhvillohet. Sa më sipër pretendimi juaj nuk qëndron.

Objekti i veprimtarisë së një shoqërie tregëtare i pasqyruar në Ekstraktin e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ka karakter përgjithësues dhe nuk mund të jetë i detajuar me të gjithë elementët që parashikojnë specifikimet teknike apo preventivi për realizimin e një objekti konkret prokurimi. Komisioni pasi verifikoi Ekstraktin e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, konstaton se në objektin e veprimtarisë së tyre, për të dy Operatorët Ekonomik, ndër të tjera rezultonë se përfshihet objekti i shërbimeve të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor. Sa më sipër pretendimi juaj nuk qëndron.

Në shtojcën 8, në kriteret për kualifikim në pikën 3.3.3, është kërkuar: Operatori Ekonomik ofertues 3 (tre) saldatorët e mësipërm, duhet ti kete të patentuar me EN ISO 9606-1 dhe: Të pakten njëri prej saldatorëve të jetë i pajisur me Certifikatën ISO 14731 (të vlefshme); Të pakten 1 saldator të ketë kualifikimet 135+138 MIG-MAG, për materialet baze çelik karboni (të vlefshme); Të pakten 1 saldator të ketë kualifikimet 111 Harku Elektrik, për materialet baze çelik karboni (të vlefshme). Për sa me sipër të paraqiten dokumenta që vertetojnë kualifikimet e kerkuara si dhe listepagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore Sipas formularit E/Sig-25 për periudhën Qershor-Nëntor 2018. BASHKIMI I OPERATORËVE EKONOMIK "ALBA ELETTRICA & 3-A PROFILE" SH.P.K, për përmbushjen e këtij kriteri ka paraqitur çertifikatë ISO 14731, me Nr. Çert 07.202.08C 2015 34166, në emër të H.P, e vlefshme deri në datën 13.10.2020. Gjithashtu për plotësimin e kriterit Saldatorë me kualifikim MIG-MAG dhe Harku Elektrik, kanë paraqitur çertifikatat me Nr. serial 0048 në emër të B.K, me Nr.serial 0049 në emër të A.H, Nr. serial 0050 në emër të D.L., Nr. serial 0051 në emër të E.I. Të 5 (pesë) këta punonjës përfshihen në listë pagesat e Operatorit Ekonomik "3-A PROFILE" sh.p.k. Dokumentacion i verifikuar në ofertën e paraqitur plotëson kriterin e kërkuar në DT, pasi BOE ka paraqitur dokumentacionin e duhur në përmbushje të kriterit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor në dokumentat e tenderit, nëpërmjet të cilës, vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale për të përmbushur kontratën. Sa më sipër pretendimi juaj nuk qëndron.

BASHKIMI I OPERATORËVE EKONOMIK "ALBA ELETTRICA & 3A -PROFILE" SH.P.K për përmbushjen e këtij kriteri ka paraqitur Ing. A.L, Ing.D.B, të cilët janë të Operatorit Ekonomik "ALBA ELEKTRIKA" SHPK, dhe Ing M.M, i Operatorit Ekonomik "3A-PROFILE" SH.P.K, të cilët plotësojnë kriterin e kërkuar. Për inxhinierët e mësipërm janë paraqitur diploma, kontrata e punës si dhe janë të përfshirë në listëpagesat e tyre. Kjo procedurë prokurimi, është Tender i hapur, shërbime me çelsa në dorë. Në Kontratën e Bashkëpunimit nuk është shprehur se Operatori Ekonomik "3A -PROFILE " SH.P.K, do të kryej punimet mekanike dhe se Operatori Ekonomik "ALBA ELETTRICA" SH.P.K, do të kryej punimet elektrike, por është shprehur se zërat e punimeve do të përcaktohen në momentin e detajimit të zërave të punës që do të miratohet pas lidhjes së kontratës dhe me miratimin e listës së shërbimeve që do të kryhen dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktor. Gjithashtu nga verifikimi i kësaj kontrate bashkëpunimi, konstatohet se oferta dhe dokumentacioni i paraqitur nga ky bashkim operatorësh është në përputhje të plotë me kërkesat e kërkuara sipas VKM 914/2014, neni 74, i ndryshuar. Sa më sipër pretendimi juaj nuk qëndron.

BASHKIMI I OPERATORËVE EKONOMIK "ALBA ELETTRICA & 3A -PROFILE" SH.P.K, për përmbushjen e këtij kriteri ka paraqitur Çertifikatat si më poshtë : Operatori Ekonomik "ALBA ELETTRICA" SH.P.K, ÇERTIFIKATË ISO 9001: 2015; ISO 14001: 2015; OHSAS 18001: 2007; të lëshuar nga kompania Çertifikuese EURO Çert, e njohur nga organizata ndërkombëtare IAF, Operatori Ekonomik "3A-PROFILE" SH.P.K, ÇERTIFIKATË ISO 9001: 2015; ISO 14001: 2015; OHSAS 18001: 2007; të lëshuar nga kompania Çertifikuese RIG Çert, e njohur nga organizata ndërkombetare IAF. Kompania Çertifikuese EURO Çert, është e njohur nga organizata ndërkombëtare IAF, dhe kompania Çertifikuese RIG Çert, është e njohur nga organizata ndërkombëtare IAF. Per kete arsye, Komisioni e konsideron të përmbushur kërkesën e sipërcituar. Sa më sipër pretendimi juaj nuk qëndron.

BASHKIMI I OPERATORËVE EKONOMIK "ALBA ELETTRICA & 3A-PROFILE" SH.P.K., për përmbushjen e këtij kriteri ka paraqitur makineritë dhe paisjet si më poshtë: Autovinç me kapacitet mbajtes 100 ton (shoqëruar me çertifikatë, foto dhe Kontratë Noterjale Nr.26, datë.05.01.2019) Autovinç me kapacitet mbajtes 50 ton (shoqëruar me çertifikatë, foto dhe Kontratë Noterjale Nr.27, datë.05.01.2019), Kamion vinç me kapacitet mbajtes 10 ton (shoqëruar me foto dhe Çertifikata e

Pronësisë), Aparat pentograf oksigjen/plazëm, faturë Nr.32913, datë.03.07.2010, (shoqëruar me foto) dy aparat saldimi me elektrode, faturë Nr.1213, datë. 13.09.2010 dhe faturë Nr.176, datë.30.04.2010, (shoqëruar foto), Aparat saldimi me hark të zhytur/karel, faturë Nr. 65, datë 17.08.2017 (shoqëruar me foto), Dy Aparate saldimi me tel, faturë Nr.3054, datë.13.06.2015, (shoqëruar foto) Frezë, faturë Nr. 49, datë 13.12.2013 (shoqëruar foto) Kalandër, faturë Nr.103, datë 06.11.2013 (shoqëruar dhe me foto), Makineri filetimi, faturë Nr. 807, datë 28.08.2018 (shoqëruar me foto), Makineri skuadrimi, faturë Nr. 807, datë 28.08.2018 (shoqëruar me foto), Matrapik, faturë Nr.238003693, datë 28.09.18 dhe faturë Nr.175, datë 30.04.2010, (shoqëruar me foto), Paisje lyerje për metal faturë Nr.807, datë 28.08.2018, shoqëruar me foto), Paisje ngrohje për elektroda faturë Nr 807, datë 28.08.2018, (shoqëruar me foto) Piegatriçe, faturë Nr. 102, datë 10.11.2017, (shoqëruar me foto) Plataform për teleskop, faturë Nr. 807, datë 28.08.2018, (shoqëruar me foto) Puahsonmatriçe, faturë Nr. 807, datë ..28 08. 2018, (shoqëruar me foto), Sbiatriçe faturë Nr. 875, datë 30.11.2018, (shoqëruar me foto), Sharrë metalike, faturë Nr. 1454, datë 15/09/2011, faturë Nr. 807, datë 28. 08. 2018, (shoqëruar me foto), Torno, faturë Nr. 66, datë 17.08.2017, (shoqëruar me foto), Tranxhë, faturë Nr.93, datë 18.10.2013 (shoqëruar me foto) Trapan faturë Nr.1213, datë 13.09.2010 dhe faturë Nr.176, datë.30.04.2010 (shoqëruar me foto) Zmusatriçe me aksesore matrik, faturë Nr.875, datë 30.11.2018 (shoqëruar me foto), Skela 3 ton, faturë Nr.28, datë 11.08.2018, (shoqëruar me foto). Nga sa më lartë, shihet qartë se BASHKIMI I OPERATORËVE EKONOMIK "ALBA ELETTRICA & 3A-PROFILE" SH.P.K., kanë paraqitur të gjitha makineritë dhe paisjet sipas listës së kërkuar në kriteret për kualifikim. Gjithashtu nuk konstatohet se këto paisje janë blerë ditët e fundit para hapjes së tenderit, por janë blerë përgjatë aktivitetit të ushtruar nga këto shoqëri deri në vitin 2018. Pavarësisht këtij pretendimi, nuk mund të konsiderohet shkelje blerja e tyre qoftë edhe një ditë para hapjes së tenderit, ky fenomen është vënë re në dokumentacionin e paraqitur nga ana juaj në ofertën e paraqitur.

BASHKIMI I OPERATORËVE EKONOMIK "ALBA ELETTRICA & 3A-PROFILE" SH.P.K., për përmbushjen e këtij kriter ka paraqitur: Kontratë Nateriale për qiradhënie, Nr. 27 Rep. dhe Nr.15 Kol., datë 05.01.2019, lidhur ndërmjet shoqërisë "AUTOVINÇ DURRËS" shpk dhe BASHKIMI I OPERATORËVE EKONOMIK "ALBA ELETTRIKA & 3A-PROFILE" SH.P.K, për përmbushjen e këtij kriter kanë paraqitur për një vinç me kapacitet deri 90 t i cili është shoqëruar dhe me skedën teknike të tij ku përcakton peshëmbajtjen deri në 90 T, e cila plotëson kriterin e kërkuar në DT. Kontratë Nateriale për qiradhënie, Nr. 26 rep. dhe Nr.14 kol., datë 05.01.2019, lidhur ndërmjet shoqërisë "AUTOVINÇ DURRSI" shpk dhe BASHKIMI I OPERATORËVE EKONOMIK "ALBA ELETTRIKA & 3A-PROFILE" SH.P.K, për përmbushjen e këtij kriter kanë paraqitur për një vinç me kapacitet deri 120 t i cili është shoqëruar dhe me skedën teknike të tij ku përcakton peshëmbajtjen deri në 120 T, e cila plotëson kriterin e kërkuar në DT. Sa më sipër pretendimi tuaj nuk qëndron.

BASHKIMI I OPERATORËVE EKONOMIK "ALBA ELETTRICA & 3A-PROFILE" SH.P.K., për përmbushjen e këtij kriter ka paraqitur një akt marrëveshje të lidhur ndërmjet OPERATORIT EKONOMIK "SËISS APROVAL ALBANIA" SH.P.K. (SAA) DHE BASHKIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIK "ALBA ELETTRICA & 3A-PROFILE" SH.P.K, e shoqëruar me Çertifikatë Akreditimi nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, Programi i Akreditimit në të cilën përfshihet dhe fusha që kërkohet në kriteret për kualifikim si dhe Akt Miratimi (Organ Evropian i Notifikuar) miratuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Sa më sipër pretendimi juaj nuk qëndron.

Gjithashtu Komisioni i Shqyrtimit të Ankeses gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur në ofertë nga ana juaj ka konstatuar se Kontrata e shërbimit lidhur ndërmjet Operatorit Ekonomik "TEC-Inspekt" sh.p.k. dhe Operatorit Ekonomik "Europa" sh.p.k. për kriterin e veçantë për

kualifikim pika 3.3.7. në të cilën kërkohet: Operatori Ekonomik ofertues, duhet të paraqesë një dokument akt- marrëveshje me një trup inspektues e akredituar sipas SSH EN17020 vlerësimi konformiteti, për kryerjen e shërbimeve të inspektimit në paisjen ngritëse (vinçave urë industrial të tonazhit të lartë) e lëshuar nga Drejtoria e Akreditimit, ku të përshkruhet fusha e inspektimit përkatës (e cila duhet të përputhet me fushën e kërkuar) është dokument i pa rregullt, sepse te të dhënat e kontratës së shërbimit thuhet se kontrata përbehet nga tre fletë, në faktë janë paraqitur dy fletë, data e efektit është data 06.11.2017, ndërsa afati i kontratës fillon në datën 03.10.2018. Po kështu në objektin e kësaj kontrate nuk përfshihet inspektimi dhe testimi i shërbimit objekt kontrate ose për të tretë, por vetëm për paisjet dhe vinxhat pronë e operatorit ekonomik "Europa" sh.p.k. Operatori Ekonomik "TEC-Inspekt" sh.p.k. sipas çertifikatës së akreditimit dhe aktit të miratimit, nuk është një organ europian i notifikuar, pra nuk ka çertifikatë të njohur nga BE-ja, kërkesë e Termave të Referencës për këtë tender. Komisioni i shqyrtimit të ankesave nga verifikimi i stafit teknik të operatorit ekonomik "Europa" sh.p.k. rezultoi se për periudhën e kërkuar në kriteret për kualifikim, nuk ka në listëpagesa drejtuesin teknik, Ing. E.D, si dhe nuk ka inxhinier elektrik, Gjithashtu mungon një vinçierë i pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të, si dhe P.F, sipas dëshmisë së kualifikimi të sigurimit teknik është deklaruar tornitor, por në listëpagesa rezulton të jetë frezatorë. Për mangësitë e konstatuara Operatori Ekonomik "EUROPA" SH.P.K., duhej të skualifikohej nga KVO. [...]"

II.6.Në datën 30.01.2019 pala ankimuese "Europa" sh.p.k. ka paraqitur për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur në autoritetin kontraktor, si dhe kundërshton arsyet e ngritura nga KSHA për skualifikimin e ofertës së tij, me argumentimin si më poshtë vijon:

"[...]Ju bejme me dije se bashkimi i operatoreve Albaletrica shpk & 3A Profile shpk nuk ka paraqitur sherbime te ngjashme (sipas objektit te tenderit) me vlere jo me te vogel se 35.000.000 leke. ju bejme me dije preventivi i publikuar ne app ka punime mekanike dhe elektrike, dhe punimet mekanike zënë pjesen me te madhe te preventivit, ndersa shoqeria Albaletrika qe eshte kryesuese ka paraqitur ne tender vetem fatura me sherbime/punime elektrike pasi ate objekt ka edhe ne ekstraktin e QKB, dhe pasi kemi kontrolluar edhe buletinet e app, kemi verejtur kryesuesi i bashkimit te perkohshem te shoqerive NUK ka sherbime te ngjashme te kryera ne fushen mekanike apo elektro-mekanike. Ndersa anetari tjeter i bashkimit te perkohshem, me perqindje me te vogel ne akt-mareveshje, shoqeria 3A Profile shpk ka marr persiper punimet mekanike. Shoqeria jone ka verejtur te gjitha buletinet e app, dhe kemi verejtur qe shoqeria 3A Profile shpk ka realizuar vetem nje kontrate me ShA Porti Detar Durres me objekt "rehabilitim vincash..." por kjo kontrate te cilen e ka paraqitur edhe ne kete proceure tenderi eshte jashte afatit 3-vjecar te percaktuar ne piken 3.3 te kriterve te vecanta per kualifikim. Gjithashtu shoqeria 3A Profile shpk ka paraqitur edhe fatura tatimore shitje per sherbime/punime me operatore private, por ne situacionet bashkangjitur keto zera sherbime/punime NUK jane te ngjashem me objektin e tenderit dhe preventivit 'per rehabilitim vincash....', pasi jane zera punimesh te ndryshem dhe objekt i ndryshem. Ky bashkim operatoresh ekonomik kane paraqitur ne tender kontraten e realizuar se bashku me AK-KESH me objekt "furnizim dhe montimi i sistemit te mbledhjes ndarjes se vajit nga uji dhe drenazhimi i ujit te transformatorete dhe hidroturbinat ne HEC Fierze dhe HEC Vau Dejes", por kjo kontrate nuk permbush kriterin e tenderit, pasi nuk ka zera te ngjashem me zerat e preventivit te tenderit objekt ankese. AK në pergjigjen e ankeses sone shprehet se ne kontraten e bashkepunimit nuk percaktohet se cili operator do te kryeje punimet elektrike dhe cili ato mekanike, por do te percaktohet ne momentin e lidhjes se kontrates. Ky arsyetim eshte kunder rregullave te prokurimit publik,

vkm914/2014 i ndryshuar, neni 74 pika 2, ku citohet konkretisht “Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/fuznizimit dhe elementet konkrete; që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.” Ju bejme me dije KPP-së , se ky fakt është shkak kryesor për s’kualifikim të BOE Albalelettrica shpk & 3A Profile shpk në kete procedure prokurimi. Ju bejme me dije KPP-së , se ak-KESH sha, në përlogaritjen e fondit limit, ka bere edhe përlogaritjen e secilit zë të preventivit, dhe në kete preventive, zerat e shërbimeve/ punimeve mekanike zënë pjesen më të madhe të vlerës financiare sesa zerat e shërbimeve/punimeve elektrike. Albalelettrica shpk , për të qene kryesuese e bashkimit të perkohshëm, ka rritur qellimisht vlerën e shërbimeve/punimeve elektrike dhe ka ulur vlerën e shërbimeve/punimeve mekanike, prandaj autoriteti juaj kontraktor duhet të s’kualifikojë keto operatore ekonomik pasi kryesuesi nuk plotëson kriterin për shërbime të ngjashme (sepse nuk ka asnjë punë mekanike) të cilat janë shërbime/punime mekanike në shumicën e tyre dhe shërbime/punime elektrike. Dhe në rastin konkret, bashkimi i perkohshëm i operatoreve të perkohshëm Albalelettrica shpk & 3A Profile shpk nuk ka paraqitur shërbime të ngjashme (sipas objektit të tenderit) me vlerë jo më të vogël se 35.000.000 leke . Ndërsa KSHA e KESH sha, në kthim përgjigjen nr. 348/2 prot date 22.01.2019, sqaron se : bashkimi i operatoreve ekonomik Albalelettrica shpk & 3A Profile shpk ka paraqitur kontratën me nr.2996/8 prot date 07. 09.2017 me objekt ”FURNIZIM DHE MONTIMI I SISTEMIT TË MBLEDHJES, NDARJES SË VAJIT NGA UJI DHE DRENAZHIMI I UJIT TË TRANSFORMATORËT DHE HIDROTURBINAT NË HEC FIERZË DHE HEC VAU DEJËS”, me vlerë 173.812.835 lek shoqëruar me formular vlerësimi dhe fatura, gjithashtu këta operatore ekonomik kanë paraqitur edhe fatura me operatore të ndryshëm lidhur me mallrat dhe shërbimet që do të furnizohen për këte kontratë.... I bejme me dije KPP se : nr.2996/8 prot date 07.09.2017 me objekt ”FURNIZIM DHE MONTIMI I SISTEMIT TË MBLEDHJES, NDARJES SË VAJIT NGA UJI DHE DRENAZHIMI I UJIT TË TRANSFORMATORËT DHE HIDROTURBINAT NË HEC FIERZË DHE HEC VAU DEJËS” , e paraqitur nga bashkimi i OE Albalelettrica shpk & 3A Profile shpk nuk përmbush kriterin e kerkuar në DST për “shërbime të ngjashme.” pasi kjo kontratë ka zëra shërbimesh për “furnizim, montim, ndarje të vajit nga uji....” , ndërsa objekti i tenderit ka zëra shërbimesh/punimesh për rehabilitim elektro-mekanik të vincave, pra nuk ka asnjë zë shërbimi të ngjashëm me kontratën që ka paraqit bashkimi i OE Albalelettrica shpk & 3A Profile shpk. gjithashtu në këte kontratë të paraqur në tender, kryesues ka qene shoqëria 3A Profile shpk . Ndërsa në tenderin objekt ankese, kryesues është shoqëria Albalelettrica shpk, pra kryesuesi i kesaj procedure objekt ankese nuk ka paraqitur shërbime të ngjashme të se njëjtes natyre siç kerkohet në dst dhe në VKM nr. 914 date 29.12.2014 neni 28. I bejme me dije KPP se : siç e kemi arsyetuar edhe më lart, bashkimi i OE Albalelettrica shpk & 3A Profile shpk nuk ka paraqitur kontratë dhe/ose fatura për shërbime të ngjashme, sipas përcaktimeve të DST, LPP, RPP . Albalelettrica shpk nuk ka paraqitur kontratë dhe/ose fatura për shërbime të ngjashme (sipas zerave të preventivit të tenderit objekt ankese), duke marrë parasysh përqindjen në kontratën e bashkëpunimit 3A-Profile shpk nuk ka paraqitur kontratë për shërbime të ngjashme (sipas zerave të preventivit të tenderit objekt ankese), duke marrë parasysh përqindjen në kontratë të bashkëpunimit. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe KPP në ”vendimet e saj nr.810/2016; vendimin nr.179/2017; vendimin nr.274/2017; vendimin nr. 401/2014. Prandaj i kërkojmë KPP të mbajë të njëjtin standart gjykim . Albalelettrica shpk & 3A Profile shpk nuk plotëson këtë kriter për kualifikim. Kërkojmë pranimin e ankesës tone për këte pikë . Ky operatori ekonomik , në këte shtojcë deklaroi se “.është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit” Po të vërejmë ekstraktin historik QKB të shoqërisë 3A Profile shpk, përcaktohet si objekt aktiviteti ;

Import-eksport i pjeseve te kembimit per mjete transporti dhe makineri te te gjitha llojeve. Import eksport, tregtim me shumice e pakice i te gjitha llojeve te materialeve te ndertimit, profile hekuri, lllamarine, hekur, çimento, tulla, etj. Projektimi, ndertimi i veprave civile, industriale, turistike, restaurime, ndertime rrugore, ndertime vepra arti rrugore dhe hekurudhore, ndertime hidroteknike, punime mbrojtese e sistemim hidraulik, etj" Pra ne ekstraktin e QKB te shoqerise 3A Profile shpk nuk ka objekt sipas tenderit objekt ankese. Tenderi objekt ankese ka sherbim te rehabilitimit elektro-mekanik te vincit, i cili eshte pajisje ngritese e levizshme industrial, ndersa ne ekstraktin e QKB se 3A-profile shpk ka ndertim te veprave civile dhe industrial dhe nuk ka sherbime rehabilitimi te pajisjeve ngritese, levizese industriale ndertimi i veprave civile dhe industrial dhe rehabilitimi/rregullimi i pajisjeve industrial (vinca etj...) jane dy objekte te ndryshme. Plotesimi i shtojces 7 nga ana 3A Profile shpk eshte i pa-rregullt . Ndersa KSHA e KESH sha, në kthim pergjigjen nr. 348/2 prot date 22.01.2019, sqaron se : Objekti i veprimtarise se nje shoqerie tregtare ka karakter pergjithesues dhe nuk mund te jete i detajuar me te gjithë elementet qe parashikojne specifikimet teknike apo preventivi... KSHA gjykon se ne objektin e veprimtarise se dy operatoreve ekonomik te jete perfshire objekti i sherbimeve te kerkuara nga Ak..... I bejme me dije KPP se : sic e kemi arsyetuar edhe më lart, shoqeria 3A Profile shpk nuk ka objekt te veprimtarise ne ekstraktim e QKB te ngjashem me objektin e prokurimit, pasi : Tenderi objekt ankese ka sherbim te rehabilitimit elektro-mekanik te vincit, i cili eshte pajisje ngritese e levizshme industrial, ndersa ne ekstraktin e QKB se 3A-profile shpk ka ndertim te veprave civile dhe industrial, dhe nuk ka sherbime rehabilitimi te pajisjeve ngritese, levizese industriale. ndertimi i veprave civile dhe industrial dhe rehabilitimi/rregullimi i pajisjeve industrial (vinca etj...) jane dy objekte te ndryshme Te njejtin qendrim ka mbajtur edhe KPP në vendimin e saj nr.712/2018. Prandaj i kerkojme KPP te mbaje te njejtin standart gjykimi. Shoqeria 3A Profile shpk nuk ploteson kete kriter per kualifikim . Kerkojme pranimin e ankeses tone per kete pike.

Në dst , ne kriteret e vecanta te kulifikimit, pika 3 kerkohen : 3. Operatori ekonomik ofertues 3 (tre) saldatorët e mësipërm, duhet ti kete të patentuar me EN ISO 9606-1 dhe: Të pakten njëri prej saldatorëve të jetë i pajisur me Çertifikatën ISO 14731 (të vlefshme); Të pakten 1 saldator të ketë kualifikimet 135+138 MIG-MAG, për materialet baze çelik karboni (të vlefshme); Të pakten 1 saldator të ketë kualifikimet 111 Harku Elektrik, për materialet baze çelik karboni (të vlefshme). bashkimi i perkohshem i operatoreve te perkohshem Albaletrica shpk & 3A Profile shpk nuk ka paraqitur kualifikimet e mesiperme per 3 saldatorët , sipas percaktimit te bere nga AK ne dst. Nuk jane paraqitur certifikatat EN ISO 9606-1 me kualifikimet ISO 14731, 135+138 MIG-MAG, 111 Harku Elelarik, sipas percaktimit te bere nga AK ne dst. Certifikatat per saldatorët te paraqitur nga ky bashkim operatoresh, nuk jane sipas percaktimit te mesiperm te kriterëve te vecanta per kualifikim te dst, nuk jane te vlefshme, si dhe nuk jane te perkthyer ne shqip . Ndersa KSHA e KESH sha, në kthim pergjigjen nr. 348/2 prot date 22.01.2019, sqaron se : Bashkimi i OE Albaletrica shpk & 3A Profile shpk ka paraqitur certifikatat ISO 14731, me nr. Cert 07.202.08C 2015 34166 ne emer te HP... ka paraqitur saldator me kualifikim MIG-MAG dhe Harku Elektrik, kane paraqitur certifikatat me nr. serial 0048 ne emer te B.K. me nr serial 0049... I bejme me dije KPP se : ky arsyetim i KSHA eshte ne kundërshtim me kriterin e vendosur ne DST, pasi nuk jane paraqitur 3 saldator të patentuar me EN ISO 9606-1, si dhe keto certifikata te paraqitur prej 3A Profile shpk nuk kane percaktimet e vendosura ne kriteret per kualifikim : 135+138 MIG-MAG, për materialet baze çelik karboni (të vlefshme); kualifikimet 111 Harku Elektrik, për materialet baze çelik karboni (të vlefshme). Keto certifikata te paraqitura nga BOE Albaletrica shpk & 3A-Profile shpk nuk jane te perkthyer ne shqip te njejtin qendrim ka mbajtur edhe KPP ne vendimet e saj 693/3 date 17.07.2012. Prandaj i kerkojme KPP te mbaje te njejtin standart gjykimi. Albaletrica

shpk & 3A Profile shpk nuk ploteson kete kriter per kualifikim. Kerkojme pranimin e ankeses tone per kete pike. 2.Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij të paktën 35 (Tridhjetë e pesë) punonjës të pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Qershor-Nëntor 2018, nga të cilët 19 prej tyre të jenë të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të, nga të cilët të jenë të paktën:

1 Inxhinier Elektrik

2 Inxhinier Mekanik

1 Inxhinier Mekatronik

2 Vinçier

2 Elektriçist

1 Specialist Mekanik

1 Axhustator

1 Frezator

1 Tornitor

3 Saldatorë

2 Montues

2 Bojaxhi

Për sa me sipër të paraqiten dokumenta që vertetojnë kualifikimet e kerkuara si dhe listepagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore sipas formularit E/Sig-25 për periudhën Qershor - Nëntor 2018. Albalelettrica shpk & 3A Profile shpk ka paraqitur vetem dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik per inxhinierat e kerkuar, por nuk ka paraqitur diplomat qe vertetojne se keta persona jane inxhiniera. Duke qene se punimet mekanike jane marre persiper nga shoqeria 2A Profile shpk, 2 inxhinierat mekanik dhe inxhinieri mekatronik duhet te ishin nuk ka paraqitur nga kjo shoqeri. Dëshmite e kualifikimit te sigurimit teknik nuk vertetojne se personat e paraqitur jane inxhinier te diplomuar. Por po jua theksojme qe ne tender BOE Albalelettrica shpk & 3A Profile shpk nuk jane paraqitur diplomat per 2 inxhiniera mekanik dhe inxhinier mekatronik . Ju bejme me dije se po te vereni me kujdes listepagesat e paraqitura ne tender nga Albalelettrica shpk dhe 3A Profile shpk, ne kodet e listepagesave perkatese, nuk ka asnje person me kodin perkates (kodi 2149.08) per inxhinier mekatronik sipas percaktimit te administrates tatimore. Nga ana e bashkimit te operatoreve eshte paraqitur 1 deshmi kualifikimi per inxhinier mekatronik, i pashoqeruar me diplome per inxhinier mekatronik. Dhe kete rast kemi te bejme me paraqitje te dokumentacionit te rremë per qellime kualifikimi, dhe autoriteti juaj kontraktor duhet te beje verifikimet perkatese ne baze te LPP dhe RPP, duke u nisur nga fakti i mesiperm. Albalelettrica shpk & 3A Profile shpk nuk ploteson kete kriter per kualifikim . Kerkojme pranimin e ankeses tone per kete pike. Ju bejme me dije se ne mareveshjen e bashkepunimit midis Albalelettrica shpk dhe 3A Profile shpk, shoqeria 3A Profile shpk ka marr persiper te kryeje te gjitha sherbimet/punimet mekanike, por ne listepagesat e saj te cila i keni ne system te app, verehet (edhe sipas kodit te listepagesave) se shoqeria 3A Profile shpk ka vetem 1 inxhinier mekanik z.Maksim Manushi, dhe nuk ka 2 inxhiniera mekanik. Ndersa shoqeria Albalelettrica shpk ka paraqitur 1 inxhinier mekanik, por ne mareveshjen e bashkepunimit kjo shoqeri ka marr persiper sherbimet/punimet elektrike. Dmth shoqeria 3A Profile shpk nuk ploteson kapacitetet teknike-profesionale per stafin inxhinierik, per sherbimet/punimet qe ka marr persiper te kryeje ne baze te akt-mareveshjes dhe ndaljes se sherbimeve/punimeve. Ndersa KSHA e KESH sha, në kthim pergjigjen nr. 348/2 prot date 22.01.2019, per pikat IV dhe V te ankeses tone, ka dhene nje perigiigie/arsyetim, dhe sqaron se : Bashkimi i OE Albalelettrica shpk & 3A Profile shpk ka paraqitur ing. A.L. , ing D.B. te cilet jane te Albalelettrica shpk dhe ing. M.M i operatorit 3A Profile shpk , te cilet plotesojne kriterin e kerkuar. Per inxhinieret e mesiperm jane paraqitur

diploma, kontrata e punes, si dhe jane te perfshire ne listepagesa I bejme me dije KPP se : ky arsyetim i KSHA eshte ne kundërshtim me kriterin e vendosur ne DST, pasi sic e shpjegon edhe KSHA ne kthim pergjigje, Albaelettrica shpk ka paraqitur ing. A.L., ing D.B te ciletjane ing elektrik A. L. dhe ing elektrik D. B., ndërsa operatorit 3A Profile shpk ka paraqitur ing mekanik M. M. dhe KSHA ne kthim pergjigjen e saj nuk permend asnje inxhinier tjeter te paraqitur prej bashkimi i OE Albaelettrica shpk & 3A Profile shpk . KSHA ne kthim pergjigjen e saj nuk permend qe bashkimi i OE Albaelettrica shpk & 3A Profile shpk ka paraqitur inxhinier mekatronik, te shoqeruar me diplome dhe deshmi sigurimi teknik. Gjithashtu KSHA, ka gabuar ne gjykim sepse në DST jane kerkuar : 1 inxhinier elektrik, 2 inxhinier mekanik, 1 inxhinier mekatronik, ndërsa bashkimi i OE Albaelettrica shpk & 3A Profile shpk ka paraqitur 2 inxhiniera elektrik, 1 inxhinier mekanik dhe nuk ka paraqitur asnje inxhinier mekatronik, sic kerkohej ne DST ne kriteret e vecanta te kulifikimit, pika 2 . Albaelettrica shpk ka ne stafin e saj te pasqyruar ne listepagesa, sipas kodit perkates te percaktuar nga administrata tatimore keta inxhinier : T. Q. inxhinier ndertesash; I. D. inxhinier elektrik; E. H. inxhinier elektrik; S. A. inxhinier ndertesash; Th. Th. inxhinier elektrik; E. D. inxhinier mekanik; E. S. inxhinier elektrik; E. N. inxhinier elektrik; V. P. inxhinier elektrik; B. Leka inxhinier elektrik; R. Ç. inxhinier elektrik; A. L. inxhinier elektrik; E. P. inxhinier elektrik; D. B. inxhinier elektrik; A. L. inxhinier mekanik. 3A Profile shpk ka ne stafin e saj te pasqyruar ne listepagesa , sipas kodit perkates te percaktuar nga administrata tatimore keta inxhinier : E. K. inxhinier ndertimi/mjedis -trajtim ujrash; E. R. inxhinier ndertimi/mjedis -trajtim ujrash; M. M. inxhinier mekanik; F. M. arkitekt ndertesash. I bejme me dije KPP se : sic verehet nga shpjegimi i mesiperm, bashkimi i OE Albaelettrica shpk & 3A Profile shpk nuk kane inxhinier mekatronik te pasqyruar ne listepagesa sipas kodit perkates te vendosur nga administrata tatimore (kodi 2149.08 per inxhinier mekatronik). I kerkojme KPP qe te beni verifikimin perkates te dokumentave te paraqitura nga Albaelettrica shpk & 3A Profile shpk per inxhinierin mekatronik. Sic verehet nga kthim pergjigja e KSHA , eshte e cuditshme se KSHA nuk e permend fare iniciallet e inxhinierit mekatronik te paraqitur nga bashkimi i OE Albaelettrica shpk & 3A Profile shpk. Po jua ritheksojme se KSHA, ka gabuar në gjykim sepse në DST jane kerkuar : 1 inxhinier elektrik, 2 inxhinier mekanik, 1 inxhinier mekatronik, ndërsa bashkimi i OE Albaelettrica shpk & 3A Profile shpk ka paraqitur 2 inxhiniera elektrik, 1 inxhinier mekanik dhe nuk ka paraqitur asnje inxhinier mekatronik, sic kerkohej ne DST ne kriteret e vecanta te kulifikimit, pika 2 . Te njejtin qendrim ka mbajtur edhe KPP në vendimet e saj nr.698/2017. Prandaj i kerkojme KPP te mbaje te njejtin standart gjykimi. Albaelettrica shpk & 3A Profile shpk nuk ploteson kete kriter per kualifikim . Kerkojme pranimin e ankeses tone per kete pike .

6.Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me Certifikatat e mëposhtme, objekti i të cilave të kete lidhje me objektin e prokurimit: 1. ISO 9001:2015; 2. ISO 14001:2015; 3. OHSAS 18001:2007; Certifikatat e mesiperme duhet te jene leshuar nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te cilet jane te akredituar nga DPA ose nga organizmat nderkombetar akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise. Ne lidhje me kete pike te paraqitet dokumentacioni vertetues. Pra sic verehet nga kerkesa per kualifikim e dst, bashkimi i operatoreve ekonomik Albaelettrica shpk & 3A Profile shpk, pervec certifikatave ISO 9001:2015, ISO 14001:2015, OHSAS 18001:2007 ne emer te Albaelettrica shpk dhe 3A Profile shpk, duhej te paraqiste edhe dokumentacionin provues se shoqeria e cila ka leshuar certifikatat e mesiperme ne emer te Albaelettrica dhe 3A Profile shpk, eshte e akredituar nga DPA ose nga organizmat nderkombetar akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise . Por po jua theksojme qe ne tender jane paraqitur vetem certifikatat ISO 9001:2015, ISO 14001:2015, OHSAS 18001:2007 ne emer te Albaelettrica shpk dhe 3A Profile shpk, dhe nuk jane paraqitur dokumentacioni vertetues (e cila eshte kerkese tjeter, e vecante per

kualifikim) se shoqeria e cila ka leshuar certifikatat e mesiperme eshte e akredituar nga DPA ose nga organizmat nderkombetar akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise. Ndersa KSHA e KESH sha, në kthim pergjigjen nr. 348/2 prot date 22.01.2019, sqaron se : Albaletrica shpk ka paraqitur certifikate ISO 9001:2015, ISO 14001:2015, OHSAS 18001:2007 te leshuar nga kompania certifikuese RIG Cert, e njohur nga organizata nderkombetare IAF, 3A Profile shpk ka paraqitur certifikate ISO 9001:2015, ISO 14001:2015, OHSAS 18001:2007 te leshuar nga kompania certifikuese EURO Cert, e njohur nga oraganizata nderkombetare IAF Kompanite EURO Cert dhe RIG Cert jane te njohura nga organizata nderkombetare IAF. Per kete arsye KSHA e konsideron te permbushur kete kerkese.... I bejme me dije KPP se : KSHA ka gabuar ne arsyetimin e saj sepse ne dst eshte kerkuar qe pervec certifikatave ISO 9001:2015, ISO 14001:2015, OHSAS 18001 te operatoreve ekonomik pjesemarres ne proceduren e prokurimit, duhej te paraqiteshin edhe dokumentacioni vertetues (e cila eshte kerkese tjeter, e vecante per kualifikim) se shoqeria e cila ka leshuar certifikatat e mesiperme eshte e akredituar nga DPA ose nga organizmat nderkombetar akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise . Albaletrica shpk & 3A Profile shpk nuk kane paraqitur dokumentacioni vertetues (e cila eshte kerkese tjeter, e vecante per kualifikim) se shoqeria e cila ka leshuar certifikatat e mesiperme EURO Cert dhe RIG Cert, eshte e akredituar nga DPA ose nga organizmat nderkombetar akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise . Te njejtin qendrim ka mbajtur edhe KPP në vendimin e saj nr.571/2018. Prandaj i kerkojme KPP te mbaje te njejtin standart gjykimi....

Ju bejme me dije se bashkimi i operatoreve ekonomik nuk i ka paraqitur ne tender keto makineri sipas percaktimit specifik te seciles prej tyre . Shoqeria 2A profile shpk e cila ka marr persiper te kryeje edhe punimet mekanike, duhej te paraqiste ne tender edhe makinerite me emertim :

Aparat pentografik oksigjen/plazëm; Aparat saldimi me hark të zhytur /karel; Frezë; Kalander makineri filetimi; Makineri skuadrimi; piegatrice; plataform teleskop; puansonmatrice; sabiatrice.

Bashkimi i operatoreve Albaletrica shpk & 3A Profile shpk, per te plotesuar kete kriter, ka paraqitur ne tender fature tatimore shitje me date te para pak diteve nga hapja e ofertave, dhe ju kerkojme juve si autoritet kontraktor qe te beni verifikimin fizik te mjeteve te seciles kompani pjesemarrese ne tender, si dhe verifikimin e faturave tatimore shitje (ku shoqeria Albaletrica shpk dhe 3A Profile shpk jane bleres dhe shoqerive qe i kane shitur keto pajisje/makineri) prane administrates tatimore, nese keto fatura jane te deklaruar prane organeve tatimore apo jo Albaletrica shpk & 3A Profile shpk nuk ploteson kete kriter per kualifikim. Kerkojme pranimin e ankeses tone per kete pike .

Në dst, ne kriteret e vecanta te kulifikimit, pika 8 kerkohen : b) Kontrata e qirasë për makinerite në fjalë duhet të jetë e shtrirë në një kohë përtej afatit të përfundimit të zbatimit të punimeve që parashikon kontrata që prokurohet. Mjetet e marra me qera nga ky bashkim operatorësh (autovincat) nuk jane te shtrirë në një kohë përtej afatit të përfundimit të zbatimit të punimeve që parashikon kontrata që prokurohet, sic percaktohet ne kete pike te dst . Për mjetet që shënohen në regjistrat publik duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin (leje qarkullimi, akt kolaudimi, siguracion, leje transporti). Pra sic verehet nga kerkesa e dst, pervec dokumentacionit te autovincave (leje qarkullimi, akt kolaudimi, siguracion, leje transporti) , operatori ekonomik duhej te paraqiste edhe certifikatat e vincave te cilat vertetoj ne kapacitetin mbajtes te vincave. Albaletrica shpk & 3A Profile shpk, kane paraqitur kontrata qeraje per 2 autovincat, te shoqeruar me leje qarkullimi, akt kolaudimi, siguracion, leje transporti , por nuk kane paraqitur certifikatat e kapacitetit mbajtes 100 ton dhe 50 ton te vincave, duke mos-plotesuar kerkesen e dst. Ndersa KSHA e KESH sha, në kthim pergjigjen nr. 348/2 prot date 22.01.2019, (per pikat VII, VIII, dhe IX te ankeses tone) sqaron se : Bashkimi i operatoreve Albaletrica shpk & 3A Profile shpk ka paraqitur

te gjitha mjetet e kerkuara, te shoqeruara e dokumentacion provues si fatura tatimore, deklarata zhdoganimi, dokumentacion provues per autovincat etj.... Per autovinc me kapacitet mbajtes 100 ton (shoqeruar me certifikate, foto, kontrate noteriale nr. 26 date 05.01.2019) , autovinc me kapacitet mbajtes 50 ton (shoqeruar me certifikate, foto, kontrate noteriale nr.27 date 05.01.2019) , kamion me vinc me kapacitet mbajtes 10 ton (shoqeruar me foto dhe certifikate pronesie) , keto vinca jane te shoqeruar me skede teknike duke plotesuar kriterin e vendosur ne dst . I bejme me dije KPP se : KSHA ka gabuar ne arsyetimin e saj sepse në dst eshte kerkuar qe : Bashkimi i operatoreve Albalelettrica shpk & 3A Profile shpk nuk ka paraqitur ne tender dokumentacionin per autovincat : leje qarkullimi, akt kolaudimi, siguracion, leje transporti. Gjithashtu skedat teknike te autovincave nuk permbushin kresen e dst, sepse ne dst jane kerkuar certifikata, dhe keto leshohen nga ent i posacem per kete qellim. Te njejtin qendrim ka mbajtur edhe KPP në vendimin e saj nr.37/2018. Prandaj i kerkojme KPP te mbaje te njejtin standart gjykimi . Ju bejme me dije KPP-së, se BOE Albalelettrica shpk & 3A Profile shpk per te permbushur kriterin e disponimit te mjeteve/pajisjeve teknike, ka paraqitur ne tender fature nr.807 date 28.08.2018 per blerje te pajisjeve : makineri filetimi, makineri skuadrimi, pajisje per lyerje me metal, pajisje ngrohje per elektroda, platform per teleskop, puansonmatrice. Ju bejme me dije se te gjitha keto pajisje mekanike jane te dimensioneve te medha, shume specifike, dhe per kete qellim ne ankesen tone drejtuar AK i kemi kerkuar AK-KESH sha qe te beje verifikimet perkatese prane administrates tatimore per deklarimin apo jo te ketyre faturave..... pasi ne kete menyre verifikohet nese OE i ka blere apo jo realisht keto makineri, pasi shoqerise tone i eshte komunikuar nga ana e shitesit te fature nr.807 date 28.08.2018 qe kjo faure nuk eshte deklaruar prane administrates tatimore si nga shitesi edhe nga bleresi Albalelettrica shpk apo 3A Profile shpk. I kerkojme KPP qe ti drejtohet me shkrese zyrtare adminitrates tatimore per deklarimin apo jo te fature nr.807 date 28.08.2018 me bleres Albalelettrica shpk apo 3A Profile shpk . (sic ka vepruar KPP në rastin e ankues-Alko Impex General Konstruktion, vendim KPP 118/2018 date 12.03.2018, ku KPP i ka kerkuar administrates tatimore me shkrese nr. 1870/4 date 31.01.2018 qe te beje verifikim perkates per pretendimin e ankimuesit) Albalelettrica shpk & 3A Profile shpk ka paraqitur nje akt-mareveshje me trup inspektues i cili nuk eshte i akredituar sipas SSH EN 17020 vlërsimi konformiteti, për kryerjen e shërbimeve të inspektimit në paisjen ngritëse (vinçave urë industrial të tonazhit të larte) e lëshuar nga Drejtoria e Akreditimit, si dhe ne dokumentacionin e trupes inspektuese nuk ka te percaktuar ne certifikaten e akreditimit dhe programin e akreditimit te lëshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit, fushen perkatese per vinca tip ure dhe vinca te levizshem. Ndersa KSHA e KESH sha, në kthim pergjigjen nr. 348/2 prot date 22.01.2019, sqaron se : Bashkimi i operatoreve Albalelettrica shpk & 3A Profile shpk ka paraqitur akt-mareveshje me trupen inspektuese “Sëiss Aproval Albania ” shpk (SAA) e shoqeruar me me Çertifikate Akreditimi nga DPA, Programi i Akreditimit, ne te cilin perfshihet fusha qe kerkohet ne kriteret per kualifikim si dhe Akt Miratimi (Organ Evropian i Notifikuar) miratuar nga MIE.I bejme me dije KPP se : KSHA ka gabuar ne arsyetimin e saj sepse Bashkimi i operatoreve Albalelettrica shpk & 3A Profile shpk nuk ka paraqitur aktmarrëveshje me një trup inspektues e akredituar sipas SSH EN 17020 vlërsimi konformiteti, për kryerjen e shërbimeve të inspektimit në paisjen ngritëse (vinçave urë industrial të tonazhit të lartë) e lëshuar. nga Drejtoria e Akreditimit, ku të përshkruhet fusha e inspektimit përkatës (e cila duhet të përputhet me fushën e kërkuar), sipas percaktive te dst. Albalelettrica shpk & 3A Profile shpk nuk ploteson kete kriter per kualifikim. Te njejtin qendrim ka mbajtur edhe KPP në vendimin e saj nr.571/2018. Prandaj i kerkojme KPP te mbaje te njejtin standart gjykimi. Kerkojme pranimin e ankeses tone per kete pike.

Më sipër kemi argumentuar për s'kualifikim të Bashkimi i Operatoreve Albaletrika shpk & 3A Profile shpk, të cilën KSHA nuk e pranoi në shkresën nr. 348/2 prot date 22.01.2019 (marre nga neve me datë 23.01.2019) me lende "vendim shqyrtim ankese", ndërsa me poshtë vijon po ju paraqesim argumentet tona për vendimin e KSHA për të shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur nga ankuesi shoqëria EUROPA shpk, duke bërë rivlerësim të procedurës dhe duke s'kualifikuar ankuesin shoqëria EUROPA shpk, vendim ky totalisht në kundërshtim me LPP, VKM nr. 914 datë 29.12.2014, si dhe të gjithë praktiken e deritanishme të KPP si organ epror në fushën e prokurimeve (ju lutem të shihni vendimet e KPP: vendim KPP 89/2018 datë 01.03.2018, vendim KPP 467/2018 datë 18.07.2018, vendim KPP 649/2018 datë 02.10.2018, vendim KPP 514/2017 datë 12.07.2017, vendim KPP 798/2017 datë 27.12.2017, vendim KPP 420/2018 datë 22.06.2018) Sqarojme KPP se: Vendimi i KSHA për të bërë rivlerësim të procedurës prokurimit duke s'kualifikuar ankuesin-Europa shpk është totalisht i paligjshëm, sepse në asnjë rast, në asnjë përcaktim të LPP dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 nuk përcaktohet që KSHA të bëjë rivlerësim të procedurës duke s'kualifikuar ankuesin. Përcaktimi ligjor i KSHA është: Komisioni Shqyrtimit të Ankësës, që do të thotë KSHA do të kthejë përgjigje ankuesit për të gjitha pikat e aksesit të tij, dhe do të vendosë që pranon apo rrezon pretendimet e ankuesit, dhe në asnjë rast nuk rivlerëson dokumentacionin e paraqitur në tender nga ankuesi duke bërë edhe s'kualifikim të ankuesit, pasi kjo fazë vlerësimi i ofertave është bërë nga KVO (Komisioni i Vlerësimit të Ofertave). Pra në asnjë rast nuk lejohet KSHA të bëjë rivlerësim të dokumentacionit të paraqitur nga ankuesi, dhe KPP në vendimet e saj shprehë se kur KSHA tejkalon tagrat e veta ligjore nuk merret parasysh asnjë vendim i saj, prandaj edhe shoqëria jone nuk po ju paraqet asnjë argument për të kundërshtuar s'kualifikimin e bërë nga KSHA për shoqërinë Europa shpk, por ju paraqesim shkurtimisht se: Akt-mareveshja e shërbimit me Tch-Inspekt I plotëson të gjitha kriteret e vendosura në dst, ka të përcaktuar objektin e tenderit, dhe është e firmosur nga një trupë inspektuese e akredituar nga DPA, dhe ka të gjithë dokumentacionin provues bashkangjitur. Në lidhje me drejtuesin teknik E.D dhe cila nuk përfshihet në listëpagesa sipas pretendimit të KSHA, ju bejme me dije se bëhet fjalë për inxhinierin e ndërtimit zj. E. D. (S. mbiemri i martesës) dhe cila përfshihet në listëpagesat e shoqërisë, por që në kriteret e tenderit nuk është kërkuar fare ing. Ndërtimi. Në lidhje me pretendimin e KSHA se shoqëria jone nuk ka inxhinier elektrik, ju bejme me dije se shoqëria ka të punësuar dhe përfshirë në listëpagesa ing. Elektrik zj. E. Rr. (H. mbiemri i martesës) dokumentacioni i se ciles është paraqitur në tender nga shoqëria jone. Në lidhje me pretendimin se mungon vinci me deshmi kualifikimi, ju bejme me dije se i kemi paraqitur në tender Vincieret me deshmi kualifikimi, madje edhe automakinist Gjergji Riska i cili në deshminë e automakinistit ka të përfshirë edhe lejen për vinci, e shoqëruar me deshmi sigurimi teknik. Si dhe kemi dokumentacionin e kërkuar në dst për të gjithë specialistet e kërkuar në tender, sipas kërkesave për kualifikim. Por sic e theksuam më lart, vendimi i KSHA për rivlerësim të procedurës duke s'kualifikuar ankuesin-EUROPA shpk nuk duhet të shqyrtohet fare në themel nga KPP, por të shpallet i pavlefshëm, duke lënë në fuqi vendimin e KVO për pjesën e kualifikimit të ankuesit-EUROPA shpk. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe KPP në vendimet e saj vendim KPP 89/2018 datë 01.03.2018, vendim KPP 467/2018 datë 18.07.2018, vendim KPP 649/2018 datë 02.10.2018, vendim KPP 514/2017 datë 12.07.2017, vendim KPP 798/2017 datë 27.12.2017, vendim KPP 420/2018 datë 22.06.2018) Sic shprehë KPP në njerin nga vendimet e saj, vendim KPP 649/2018, faqe 10 citon :.... Madje i bejme me dije KPP, se megjithatë KSHA ka bërë rivlerësim të procedurës duke s'kualifikuar ankuesin-EUROPA shpk, në faqen e app në llogarinë e përdoruesit EUROPA shpk, edhe në ditën e paraqitjes së ankësës tone në KPP datë 30.01.2019, rezultoi që ankuesi Europa

shpk eshte i kualifikuar, ndersa KSHA citon qe ankuesi Europa shpk eshte i s'kualifikuar ne date 22.01.2019. [...]”

II.7.Në datën 13.02.2019 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.764/1prot., datë 11.02.2019, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1.Lidhur me vendimin e komisionit të shqyrtimit të ankesave për skualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik ankimues ”Europa” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik vëren se :

III.1.1. Nga verifikimi kryer në SPE, renditja aktuale e ofertave, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, rezulton si më poshtë vijon:

1. ”Albaelettrica” & ”3A-Profile” shpk	69,934,000 lekë	Kualifikuar;
2. ”Voith Hydro” GmbH & Co.KG (VPHO)	77,777,777 lekë	Skualifikuar;
3. ”Cec Crane Engineering and Consulting” GmbH	81,672,925 lekë	Skualifikuar;
4. ”Europa” shpk	87,100,000 lekë	Kualifikuar;

III.1.2.Në nenin 54 pika 3 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji”*. Në nenin 66 pika 3 të Vendimit nr.914 të Këshillit të Ministrave datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, parashikohet se *“Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal.”* Ndërkohë në nenin 67 të Vendimit nr.914 të Këshillit të Ministrave datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, parashikohet se: *“Në bazë të ofertave të pranuar, komisioni i vlerësimit të ofertave harton klasifikimin përfundimtar, i cili u komunikohet ofertuesve në kohën e përcaktuar në këto rregulla”*.

III.1.3. Në nenin 63 pika 1.1. dhe pika 2 e Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se *“Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin. 1.1 Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit,*

derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni. 2. Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës. kur ankimesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji. Në kreun X “Shqyrtimi i Ankesave”, neni 78, pika 6 i Vendimit nr.914 të Këshillit të Ministrave datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se “Për shqyrtimin e ankesave, autoriteti kontraktor ndjek hapat e mëposhtëm: a) Titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen një komisioni të përbërë nga 3 (tre) persona, për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim. Përfundimisht, në rast të mungesës së personelit, titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen për shqyrtim 1 (një) zyrtari të vetëm. Komisioni/zyrtari i 14 ngarkuar është përgjegjës për vendimin e dhënë në përfundim të shqyrtimit të ankesës. Anëtarët e komisionit/zyrtari i ngarkuar nuk duhet të kenë marrë pjesë në marrjen e vendimit, për të cilin është paraqitur ankesa. Në rast se ankimi lidhet me dokumentet e tenderit, titullari i autoritetit kontraktor mund t’ia ngarkojë shqyrtimin e ankesës komisionit të vlerësimit të ofertave.” Në nenin 78, pika 6 gërma “ç” të Vendimit Nr.914 të Këshillit të Ministrave dt.29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet se : [...]Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, komisioni/zyrtari i ngarkuar për shqyrtimin e saj mund të marrë vendim për refuzimin ose pranimin e ankesës, i cili i komunikohet menjëherë titullarit të autoritetit kontraktor. Në rastin kur ankesa është pranuar, titullari i autoritetit kontraktor i adreson vendimin për zbatim komisionit të vlerësimit të ofertave.

III.1.4. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP, në neni 2 të tij janë ato të mos diskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërm lidhet ngushtësisht me elementë të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Në interpretim interpretim sistematik, Komisioni i Prokurimit gjykon se ligjvënësi ka ndarë qartësisht dy momentet procedurale atë të vlerësimit të ofertave nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe momentin e dytë të garancisë procedurale të mbrojtjes së interesave të ligjshëm të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, atë të ankimit administrative pranë autoritetit kontraktor (rishikimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave) nga vetë autoriteti kontraktor por nga një trupë e re, e cila nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesave me komisionin e vlerësimit të ofertave, shqyrtimin e ankesave nga K.Sh. A. (Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave). Normativa e mësipërme, parashikuar nga neni 63 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, rregullon të drejtën e personave të interesuar në një procedurë prokurimi për të paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas pranë Komisionit të Prokurimit Publik në kuadrin e rishikimit administrativ të kësaj procedure, e thënë ndryshe, legjitimitimin për të vënë në lëvizje dhe investimin e autoritetit kontraktor për rishikimin e vendimit të KVO-së. Procedura përpara autoritetit kontraktor si edhe para KPP ka natyrën e procedurave të nxitura, pasi autoriteti kontraktor dhe vetë KPP nuk mund të bëhet vetiniciatore e fillimit të

procedurave (ex officio). Si rregull, investimi i K.Sh.A dhe KPP është i bazuar (faktikisht i kufizuar) nga ankimet e sjella pranë saj vetëm nga subjekte të legjitimuar.

III.1.5. Referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, informacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik konstatohet se nga ana e operatorëve ekonomik pjesëmarrës, nuk ka qënë në asnjë rast e ankimuar oferta ekonomike e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues "Europa" sh.p.k. Në rastin konkret Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, ka dalë jashtë tagrit dhe kompetencave të saj duke konstatuar dhe nxjerrë arsye skualifikimi për operatorin ekonomik ankimues "Europa" sh.p.k., pa ju referuar ndonjë ankese të operatorëve ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi. Duke u bërë në këtë mënyrë iniciatore e rishikimit të procesit të prokurimit. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik i tërheq vëmendje autoritetit kontraktor për shkeljet e konstatuara më sipër.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "Europa" sh.p.k mbi kualifikimin e ofertës të BOE "Albaelettrica" sh.p.k. & "3A-Profile" sh.p.k, me argumentin: *"[...] Ju bejme me dije se bashkimi i operatoreve Albaelettrica shpk & 3A Profile shpk nuk ka paraqitur shërbime të ngjashme (sipas objektit të tenderit) me vlerë jo më të vogël se 35.000.000 leke. ju bejme me dije preventivi i publikuar në app ka punime mekanike dhe elektrike, dhe punimet mekanike zënë pjesën më të madhe të preventivit, ndërsa shoqëria Albaeletrika që është kryesuese ka paraqitur në tender vetëm fatura me shërbime/punime elektrike pasi atë objekt ka edhe në ekstraktin e QKB, dhe pasi kemi kontrolluar edhe buletinet e app, kemi vërejtur kryesuesi i bashkimit të perkohshëm të shoqërive NUK ka shërbime të ngjashme të kryera në fushën mekanike apo elektro-mekanike. Ndërsa anetari tjetër i bashkimit të perkohshëm, me përbindje më të vogël në akt-mareveshje, shoqëria 3A Profile shpk ka marrë për siper punimet mekanike. Shoqëria jone ka vërejtur të gjitha buletinet e app, dhe kemi vërejtur që shoqëria 3A Profile shpk ka realizuar vetëm një kontratë me ShA Porti Detar Durrës me objekt "rehabilitim vëncash..." por kjo kontratë të cilën e ka paraqitur edhe në këtë prokurim të tenderit është jashtë afatit 3-vjeçar të përcaktuar në pikën 3.3 të kriterëve të vecanta për kualifikim. Gjithashtu shoqëria 3A Profile shpk ka paraqitur edhe fatura tatimore shitje për shërbime/punime me operatore private, por në situacionet bashkëngjitur këto zëra shërbime/punime NUK janë të ngjashëm me objektin e tenderit dhe preventivit 'për rehabilitim vëncash....', pasi janë zëra punimesh të ndryshëm dhe objekt i ndryshëm. Ky bashkim operatorësh ekonomik kanë paraqitur në tender kontratën e realizuar se bashku me AK-KESH me objekt "furnizim dhe montim të sistemit të mbledhjes ndarjes së vajit nga uji dhe drenazhimi i ujit të transformatorëve dhe hidroturbinat në HEC Fierze dhe HEC Vau Dejës", por kjo kontratë nuk përmbush kriterin e tenderit, pasi nuk ka zëra të ngjashëm me zërat e preventivit të tenderit objekt ankese. AK në përgjigjen e ankesës sone shprehë se në kontratën e bashkëpunimit nuk përcaktohet se cili operator do të kryejë punimet elektrike dhe cili ato mekanike, por do të përcaktohet në momentin e lidhjes së kontratës [...]", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.2.1. Në pikën 3.3.1 të shtojcës 8, "Kapaciteti teknik", në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

"1. Ofertuesi duhet të ketë realizuar: Shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 35,000,000 (Tridhjetë e pesë milion) Lek, realizuar gjatë tre viteve të fundit nga hapja e tenderit. Në lidhje me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë :Për shërbime të

ngjashme ndaj organeve publike: Vertetime te leshuara nga enti publik dhe/ose fatura tatimore shitje ku shenohen qarte palet, datat, shumat dhe sasite e shërbimeve te realizuara. Ose Per shërbime te ngjashme ndaj privateve: Fatura tatimore shitjesh ku të jene te përcaktuara palet, datat, shumat dhe sasite e shërbimeve të realizuara.”

III.2.2. Nga verifikimi i kryer nga KPP, për plotësimin e kriterit të mësipërm, BOE ”Albaelettrica” sh.p.k. & ”3A-Profile” sh.p.k ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.):

1. Kontratë datë 07.09.2017, lidhur ndërmjet BOE ”Albaelettrica” sh.p.k. & ”3A-Profile” sh.p.k dhe KESH sh.a., me objekt “Furnizim dhe montim i sistemit të mbledhjes, ndarjes së vajit nga uji dhe drenazhimi i ujit te transformatorët dhe hidroturbinat në HEC Fierzë dhe HEC Vau Dejës”, shoqëruar me dokumentacionin përkatës.
2. Kontratë datë 05.09.2016, lidhur ndërmjet shoqërisë ”Albaelettrica” sh.p.k. dhe shoqërisë “Junik” sh.p.k., me objekt “Furnizimi dhe instalimi i impianteve, pajisjeve dhe paneleve elektrike”, shoqëruar me dokumentacionin përkatës.
3. Kontratë datë 01.06.2017, lidhur ndërmjet shoqërisë ”3A-Profile” sh.p.k. dhe Komandës Mbështetëse, me objekt “Blerje materiale Xhenio”, shoqëruar me dokumentacionin përkatës.

III.2.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”* Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.2.4. Në nenin 28, pika 3 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se *“3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe faturave tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

III.2.5. Referuar dokumentacionit të sipërcituar, të paraqitur nga BOE ”Albaelettrica” sh.p.k. & ”3A-Profile” sh.p.k në përmbushje të kriterit për eksperiencë të ngjashme gjatë tre viteve të fundit, këta të fundit kanë paraqitur në sistemin elektronik të prokurimeve Kontratë datë 07.09.2017, lidhur ndërmjet BOE ”Albaelettrica” sh.p.k. & ”3A-Profile” sh.p.k dhe KESH sh.a., me objekt “Furnizim dhe montim i sistemit të mbledhjes, ndarjes së vajit nga uji dhe drenazhimi i ujit te transformatorët dhe hidroturbinat në HEC Fierzë dhe HEC Vau Dejës”, shoqëruar me dokumentacionin përkatës;

Kontratë datë 05.09.2016, lidhur ndërmjet shoqërisë "Albaelettrica" sh.p.k. dhe shoqërisë "Junik" sh.p.k., me objekt "Furnizimi dhe instalimi i impianteve, pajisjeve dhe paneleve elektrike", shoqëruar me dokumentacionin përkatës; Kontratë datë 01.06.2017, lidhur ndërmjet shoqërisë "3A-Profile" sh.p.k. dhe Komandës Mbështetëse, me objekt "Blerje materiale Xhenio", shoqëruar me dokumentacionin përkatës. Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni, si dhe bazuar termat e referencës të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, Komisioni konstaton se BOE "Albaelettrica" sh.p.k. & "3A-Profile" sh.p.k. nuk arrin të vërtetojë se ka kryer shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit në vlerën e përcaktuar, pasi në asnjë prej kontratave të paraqitura nuk është kryer ndonjë shërbim i ngjashëm në fushën elektro-mekanike, për pajisje të ngjashme me atë pajisje për të cilën po realizohet procedura e prokurimit objekt shqyrtimi. Referuar legjislacionit për prokurimin publik, Komisioni gjykon se, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës në respekt të nenit 46 pika 1 gërma "b", të Ligjit Nr.9643 dt.20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Në këto kushte, KPP gjykon se BOE "Albaelettrica" sh.p.k. & "3A-Profile" sh.p.k. nuk ka paraqitur dokumentacion që të provojë se ka kryer shërbime të ngjashme në vlerën e caktuar nga autoriteti kontraktor, e për rrjedhojë nuk përmbush kriterin e vendosur nga ky i fundit në pikën 3.3.1 të shtojcës 8, "Kapaciteti teknik", në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "Europa" sh.p.k mbi kualifikimin e ofertës të BOE "Albaelettrica" sh.p.k. & "3-A Profile" sh.p.k, me argumentin: *Por po jua theksojme qe ne tender BOE Albaelettrica shpk & 3A Profile shpk nuk jane paraqitur diplomat per 2 inxhiniera mekanik dhe inxhinier mekatronik . Ju bejme me dije se po te vereni me kujdes listepagesat e paraqitura ne tender nga Albaelettrica shpk dhe 3A Profile shpk, ne kodet e listepagesave perkatese, nuk ka asnje person me kodin perkates (kodi 2149.08) per inxhinier mekatronik sipas percaktimit te administrates tatimore.* ", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1.Në shtojcën nr. 8, pika 3.3.2 e "Kapaciteti teknik" në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

"2.Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij të paktën 35 (Tridhjetë e pesë) punonjës të pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Qershor-Nëntor 2018, nga të cilët 19 prej tyre të jenë të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të, nga të cilët të jenë të paktën:1 Inxhinier Elektrik; 2 Inxhinier Mekanik; 1 Inxhinier Mekatronik; 2 Vinçier; 2 Elektriçist; 1 Specialist Mekanik; 1 Axxhustator; 1 Frezator; 1 Tornitor; 3 Saldatorë; 2 Montues; 2 Bojaxhi"

III.3.2. Në nenin 46, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”* Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”*

III.3.3. Në nenin 28, pika 5, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: *“5.Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*

- a)licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*
- b)një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla;dhe/ose*
- c)dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose*
- ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”.*

III.3.4. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar”, për Inxhinierin Mekatronik përcaktohet kodi sipas profesionit (2149.08).

III.3.5. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga BOE “Albaelettrica” sh.p.k. & “3-A Profile” sh.p.k, në përmbushje të kriterit të sipërcituar, konstatohet se janë paraqitur listëpagesat për periudhën Qershor-Nëntor 2018, si dhe një sërë dokumentash lidhur me stafin e dy operatorëve ekonomik pjesëmarrës në bashkimin e shoqërive, por në asnjë rast, nuk është paraqitur dokumentacion për të provuar se ky bashkim operatorësh ekonomik disponon në staf një Inxhinier Mekatronik, sikurse ka kërkuar autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi. Gjithashtu, KPP konstaton se nga verifikimi i listëpagesave të paraqitura në periudhën Qershor-Nëntor 2018, rezulton se të dy operatorët ekonomik pjesëmarrës në bashkimin e shoqërive, nuk kanë të punësuar me kod 2149.08 që i përket profesionit të Inxhinierit Mekatronik. Në këto kushte, Komisioni gjykon se BOE “Albaelettrica” sh.p.k. & “3-A Profile” sh.p.k nuk arrin të vërtetojë se disponon inxhinierin mekatronik sipas kërkesave të autoritetit kontraktor, e për rrjedhojë, nuk e përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën nr. 8, pika 3.3.2 e “Kapaciteti teknik” në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Komisioni gjykon se, operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.4.Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues "Europa" sh.p.k. për kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik BOE "Albaelettica" sh.p.k. & "3-A Profile" sh.p.k në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e mësipërme qëndrojnë pasi BOE "Albaelettica" sh.p.k. & "3-A Profile" sh.p.k nuk përmbush kriteret e veçanta të kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P. do të jetë e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij bashkimi operatorësh ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 "Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "Europa" sh.p.k. për procedurën e prokurimit "*Procedurë e Hapur*", me objekt "*Rehabilitimi elektro-mekanik i vinçit urë 250/30/5 Ton në sallën e makinerisë në HEC Vau i Dejës*", me nr. REF-97666-12-11-2018, me fond limit 89,000,000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 07.01.2019, nga autoriteti kontraktor KESH sh.a.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KSHA-së për skualifikimin e operatorit ekonomik "Europa" sh.p.k.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e BOE "Albaelettica" sh.p.k. & "3-A Profile" sh.p.k dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë bashkim operatorësh ekonomik.
4. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "Europa" sh.p.k.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 142 protokolli Datë 30.01.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha